

**VENDIM**  
**Nr. 83, datë 30.12.2015**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

|                 |                                |   |   |
|-----------------|--------------------------------|---|---|
| Bashkim Dedja   | kryetar i Gjykatës Kushtetuese |   |   |
| Vladimir Kristo | anëtar i                       | “ | “ |
| Vitore Tusha    | anëtare e                      | “ | “ |
| Fatmir Hoxha    | anëtar i                       | “ | “ |
| Gani Dizdari    | anëtar i                       | “ | “ |
| Besnik Imeraj   | anëtar i                       | “ | “ |
| Fatos Lulo      | anëtar i                       | “ | “ |
| Sokol Berberi   | anëtar i                       | “ | “ |

me sekretare Edmira Babaj, në datën 29.10.2015 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 51 Akti, që i përket:

**KËRKUES:** Nezir Bata

**SUBJEKTE TË INTERESUARA:** Fakulteti i Gjuhëve të Huaja Universiteti i Tiranës

**OBJEKTI:** Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën i vendimeve nr. 5326, datë 9.6.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 1612, datë 25.11.2009 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2014-4337 (578), datë 4.11.2014 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 42, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sokol Berberi, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Universitetit të Tiranës (Rektoratit), që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**VËREN:**

**I**

1. Kërkuesi Nezir Bata ka qenë në marrëdhënie pune pranë Fakultetit të Gjuhëve të Huaja në Universitetin e Tiranës, si pedagog i gjuhës turke në Departamentin e Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike. Për shkak të transmetimit të disa pamjeve audio-video në mediat elektronike, ku përfshihej kërkuesi, mbledhja e dekanatit ka diskutuar sjelljen e tij dhe ka vendosur pezullimin e menjëhershëm të tij nga detyra e pedagogut. Mbi bazën e këtij vendimi, Dekani i Fakultetit të Gjuhëve të Huaja ka nxjerrë vendimin nr. 434, datë 15.5.2007, me anë të të cilit ka vendosur: *“Pezullimin nga detyra të pedagogut Nezir Bata për të parandaluar dëmin që mund t'i shkaktohet më tej institucionit.”*

2. Kërkuesi i është drejtuar gjykatës me padi me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 434, datë 15.5.2007, rikthimin në vendin e mëparshëm të punës dhe detyrimin e palës së paditur (Fakulteti i Gjuhëve të Huaja) për pagesën e pagës nga data 4.4.2007 deri në rikthimin e tij në detyrë. Me vendimin nr. 5326, datë 9.6.2008, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur: *“Pranimin e pjesës së kërkesës për pjesën tjetër të saj”*.

3. Me vendimin nr. 1612, datë 25.11.2009, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur: *“Ndryshimin e vendimit nr. 5326, datë 9.6.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Shfuqizimin e urdhrin të palës së paditur nr. 434 prot., datë 15.5.2007. Detyrimin e palës së paditur t'i paguajë palës paditëse dëmshpërblimin me pagën e 12*

*muajve për shkak të zgjidhjes së kontratës së punës. Detyrimin e palës së paditur t'i paguajë palës paditëse dëmshtëpërblimin me pagën e 3 muajve për mosrespektim të afatit të njoftimit. Detyrimin e palës së paditur t'i paguajë palës paditëse dëmshtëpërblimin me pagën e 2 muajve për mosrespektim të procedurës për zgjidhjen e kontratës. Detyrimin e palës së paditur t'i paguajë palës paditëse dëmshtëpërblimin me 3 paga mujore për vjetërsi në punë. Lënien në fuqi të vendimit për moskthimin e palës paditëse në vendin e mëparshëm të punës.”.*

4. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë Universiteti i Tiranës. Me vendimin nr. 00-2014-4337 (578), datë 4.11.2014, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, ka vendosur: “*Ndryshimin e vendimit nr. 5326, datë 9.6.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe të vendimit nr. 1612, datë 25.11.2009 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe rrëzimin e padisë.”*

## II

5. **Kërkuesi** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë sipas objektit, duke parashtruar këto shkaqe në mënyrë të përmbledhur:

5.1 Është cenuar e drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka rivlerësuar provat e marra nga gjykatat e faktit, e ka bazuar zgjidhjen e çështjes në një provë që nuk është administruar në gjykimin në fakt dhe ka mbajtur një qëndrim të ndryshëm nga këto gjykata, duke tejkaluar kufijtë e shqyrtimit të çështjes. Sipas kërkuesit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë e ka mbështetur vendimin në fakte e rrethana, të cilat nuk janë pranuar si të vërteta nga gjykatat e faktit dhe ka anashkaluar konkluzionet e këtyre gjykatave mbi provat e administruara në gjykim.

5.2 Gjykatat e zakonshme, duke u shprehur se kërkuesi nuk e gëzon të drejtën e kthimit në punë, kur asnjë nga dispozitat e KP-së nuk e ndalon rikthimin në punë të punonjësve që punojnë në administratën shtetërore, praktikisht kanë shfuqizuar pikën 3 të nenit 146 dhe pikën 3 të nenit 155 të Kodit të Punës, pa e pasur një kompetencë të tillë.

5.3 Është cenuar parimi i arsytimit të vendimit gjyqësor, për arsye se mungon qartazi baza ligjore mbi të cilën gjykatat e zakonshme kanë zgjidhur mosmarrëveshjen. Arsyetimet e gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të Apelit, të mbështetura në vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë, janë të padrejta, sepse gjykatat duhet të zbatojnë ligjin dhe jo të bëjnë ligj të ri apo të udhëzojnë që ligji të mos aplikohet nëpërmjet praktikës gjyqësore.

5.4 Është cenuar parimi i sigurisë juridike për shkak të moszbatimit të neneve 146 dhe 155 të KP-së, të mosarsytimit se përse këto dispozita nuk gjejnë zbatim në rastin konkret, si dhe të mbështetjes së vendimit në praktika gjyqësore që nuk janë norma juridike.

5.5 Është cenuar e drejta e aksesit në gjykatë, pasi me rrëzimin e padisë pretendimet e kërkuesit për rikthim në punë nuk janë shqyrtuar në mënyrë substanciale, duke cenuar në thelb edhe të drejtën e rehabilitimit dhe të zhdëmtimit të personit për shkak të veprimeve dhe akteve të paligjshme të administratës publike (neni 44 i Kushtetutës).

5.6 Është cenuar parimi i gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, në kushtet kur gjykimi i çështjes ka zgjatur për rreth 7 vjet, pavarësisht se çështja nuk paraqet kompleksitet dhe as sjellja e kërkuesit nuk ka qenë e tillë që të zvarrisë gjykimin.

6. Subjekti i interesuar, **Rektorati i Universitetit të Tiranës**, në prapësimet me shkrim drejtuar Gjykatës Kushtetuese ka parashtruar në mënyrë të përmbledhur:

6.1. Kërkuesi nuk legjitimohet *ratione materiae* për pretendimet që lidhen me marrëdhëniet e punës me subjektin e interesuar, pasi ai nuk ka pasur një proces gjyqësor të përfunduar me objekt zgjidhje të kontratës së punës në mënyrë të njëanshme. Vetëm pasi kërkuesi të ezaurojë rrugën gjyqësore për këtë pretendim, mund të paraqesë kërkesë për proces të rregullt në Gjykatën Kushtetuese.

6.2 Pretendimi për cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme është i pabazuar, pasi gjykimi i kësaj çështjeje në të tria shkallët e gjykimit është bërë nga gjykata kompetente nga pikëpamja lëndore dhe tokësore, si dhe është respektuar përbërja e trupave gjyqës. Në asnjë shkallë

të gjykimit nuk ka pasur pretendime për përjashtim gjyqtari nga trupi gjyqësor.

6.3 Gjykata e Lartë në rastin konkret nuk ka marrë prova të reja, por ka analizuar dy vendimet e shkallëve më të ulëta; nuk ka bërë interpretim të ndryshëm të fakteve dhe provave të administruara gjatë gjykimit, por në analizën e vendimeve të kundërshtuara ka interpretuar ligjin dhe zbatuar praktikën unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara. Të gjitha provat e referuara nga gjykatat në të tria vendimet i janë nënshtruar hetimit dhe debatit gjyqësor.

6.4 Pretendimi për mosrespektimin e parimit të arsytimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar, pasi të tria vendimet gjyqësore janë arsyetuar në mënyrë të detajuar dhe janë argumentuar në lidhje me faktet e provat e administruara në gjykim, si dhe me ligjin e zbatueshëm. Pjesa e dispozitivit është në të njëjtën linjë me pjesën arsyetuese dhe gjykatat janë shprehur për sa është kërkuar nga pala paditëse në gjykim.

6.5 Kërkuesit nuk i është mohuar e drejta e aksesit në gjykatë, në kushtet kur ai ka qenë i pranishëm në vendimarrjet e gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të Apelit, ka marrë pjesë në fazën e hetimit gjyqësor, si dhe ka ushtruar të drejtën e ankimit dhe të paraqitjes së pretendimeve në të tria shkallët e gjykimit. Në Gjykatën e Lartë çështja është gjykuar në dhomë këshillimi pa praninë e palëve, në përputhje me procedurën e parashikuar në nenin 61 të ligjit nr. 49/2012. Edhe gjatë hetimit administrativ kërkuesi është pyetur dhe dëgjuar, si dhe i është dhënë mundësia të mbrohet.

6.6 Gjykata e Lartë ka respektuar parimin e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, duke zhvilluar gjykimin me shpejtësinë normale të ecurisë së një procesi gjyqësor civil. Për më tepër, kërkuesit nuk i është shkaktuar ndonjë dëm, pasi me paraqitjen e urdhrat për ekzekutim të detyrueshëm, detyrimi është ekzekutuar menjëherë në favor të tij.

### III

#### Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

##### *A. Për legjitimitetin e kërkuesit dhe juridiksionin e Gjykatës*

7. Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të rregullimit kushtetues të neneve 131/f dhe 134/g të Kushtetutës, si dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit të parashikuar nga neni 30/2 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”.

8. Në lidhje me legjitimitetin *ratione materiae*, sipas neneve 131/f, 134/1/g dhe 134/2 të Kushtetutës, individët kanë legjitimitet të kushtëzuar, për arsye se mund t’i drejtohen Gjykatës vetëm për pretendime të lidhura me procesin e rregullt ligjor, pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave të tyre. Nga vendimet bashkëlidhur kërkesës rezulton se Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje me anë të rekursit të paraqitur nga Universiteti i Tiranës, si palë e paditur në procesin gjyqësor. Për pasojë, në kushtet kur kërkuesi nuk i ka kundërshtuar në Gjykatën e Lartë vendimet e gjykatave më të ulëta, pretendimet në lidhje me këto vendime nuk mund të merren në shqyrtim.

9. Po ashtu, Gjykata ka theksuar se interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor dhe problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimin nr. 3, datë 19.2.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Bazuar në këto standarde, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit në lidhje me cenimin e parimit të sigurisë juridike për shkak të moszbatimit të neneve 146 dhe 155 të Kodit të Punës, dhe cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, si pasojë e mënyrës së zbatimit të ligjit dhe vendimeve unifikuese të Gjykatës së Lartë për zgjidhjen e

mosmarrëveshjes, nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues. Për pasojë, kërkuesi nuk legjitimohet *ratione materiae* në lidhje me këto pretendime.

10. Pretendimet e tjera të ngritura nga kërkuesi *prima facie* hyjnë në juridiksionin e Gjykatës dhe janë shqyrtuar prej saj në vijim.

B. Për pretendimin për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj.

11. Kërkuesi ka pretenduar se, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka rivlerësuar provat e marra nga gjykatat e faktit dhe e ka bazuar zgjidhjen e çështjes në një provë (videokaseta) që nuk është administruar në gjykimin në fakt. Edhe pse kaseta në fjalë nuk është paraqitur si provë dhe nuk është administruar nga gjykatat, Kolegji e bazon vendimin mbi këtë “provë”. Sipas kërkuesit, Kolegji Administrativ ka arritur në një përfundim të kundërt me dy gjykatat, atë të shkallës së parë dhe të Apelit, lidhur me faktin nëse është vërtetuar rasti që ka shërbyer si shkak për largimin e kërkuesit nga detyra. Ai e ka mbështetur vendimin në fakte e rrethana që nuk janë pranuar si të vërteta nga gjykatat e faktit dhe ka anashkaluar konkluzionet e këtyre gjykatave mbi provat e administruara në gjykim.

12. Shqyrtimi i çështjes nga një “*gjykatë e caktuar me ligj*” është një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Ky element karakterizohet, në kuptimin material, nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin mbi çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar mbi një procedurë ligjërishit të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik. E drejta e çdo pale për t’u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente dhe të caktuar me ligj nënkupton që gjykata të ketë juridiksion për të gjykuar çështjen dhe që kompetenca për të vendosur për të t’i jetë njohur nëpërmjet ligjit (*shih vendimet nr. 40, datë 25.6.2015; nr. 2, datë 22.1.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në kuptim të funksionit rishikues të Gjykatës së Lartë, të sanksionuar në nenin 141 të Kushtetutës, Gjykata ka vlerësuar se kompetenca e saj për shqyrtimin e çështjeve nuk bazohet mbi të njëjtat dispozita procedurale të cilave u referohen gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit. Në nocionin kushtetues të rishikimit futet, në radhë të parë, shqyrtimi i rekurseve për pretendimet e shkeljes të ligjit material ose procedural, gjë që përbën funksionin kryesor të Gjykatës së Lartë (*shih vendimet nr. 27, datë 24.6.2013; nr. 7, datë 9.3.2009; nr. 31, datë 1.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Sipas jurisprndencës kushtetuese procesi nuk konsiderohet i parregullt, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, kur Gjykata e Lartë mbi të njëjtat prova e fakte të vlerësuara në gjykimet e mëparshme vendos të prishë vendimet dhe ta zgjidhë vetë çështjen për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit (*shih vendimet nr. 27, datë 24.6.2013; nr. 7, datë 9.3.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Në ushtrimin e funksionit të saj si gjykatë e ligjit, Gjykata e Lartë mund të vendosë për themelin e çështjes vetëm nëse mosmarrëveshja mund të zgjidhet në bazë të të njëjtave fakte dhe prova të vlerësuara nga gjyqtari i faktit dhe që përbëjnë bazën e vendimit në të cilin është bërë një interpretim i gabuar i ligjit. Kontrolli i saj duhet të fokusohet vetëm në drejtim të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankimuar, pra mbi mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Gjykata e Lartë nuk mund të anashkalojë apo të lërë pa vlerë prova që janë shqyrtuar dhe vlerësuar nga gjykatat e faktit, si dhe nuk mund të pranojë prova të cilat nuk janë administruar në gjykimin në fakt. Gjykata thekson se kusht për dhënien nga Gjykata e Lartë të një vendimi mbi themelin e çështjes, është që jo vetëm të mos nevojitet administrimi i provave të reja, por edhe që provat e administruara të jenë shqyrtuar dhe vlerësuar në mënyrë të mjaftueshme nga gjyqtari i faktit (*shih vendimin nr. 40, datë 25.6.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Gjykata e Lartë nuk mund të konkludojë *a priori* nëse është vërtetuar apo jo një fakt i caktuar. Në rast se Gjykata e Lartë vlerëson se provat e administruara nuk janë të mjaftueshme për arritjen e një konkluzioni apo se nevojitet kryerja e vlerësimeve të mëtejshme të tyre, ajo nuk mund të marrë kompetencat e gjykatës të faktit, pasi një veprim i tillë bie ndesh me parimin e gjykatës së caktuar me ligj, por duhet ta kthejë çështjen për rishqyrtim, me qëllim plotësimin e këtyre të metave të vendimit. Nëse

Kolegji Administrativ ka arritur në një përfundim të ndryshëm nga gjykatat e faktit, atëherë ai duhet t'i prishë të dyja vendimet gjyqësore dhe ta kthejë çështjen për rigjykim (*shih vendimin nr. 32, datë 25.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Nga analiza e vendimeve gjyqësore rezulton se në lidhje me regjistrim video të transmetuar në media, i cili ka qenë shkak për pezullimin nga detyra të kërkuesit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë është shprehur se “... *gjatë hetimit gjyqësor të çështjes pala e paditur nuk arriti të provonte ekzistencën e shkaqeve të pretenduara në motivimin e vendimmarrjes së saj në datën 15.5.2007... Palës së paditur i bie barra e provës të provojë faktet e pretenduara lidhur me zgjidhjen e marrëdhënies së punës me paditësin. Lidhur me shkaqet e zgjidhjes së kontratës së punës, nga pala e paditur gjatë gjyqimit nuk u paraqit ndonjë provë... Transmetimi i një fakti nga një emision televiziv nuk mund të përbëjë fakt të njohur publik që nuk ka nevojë të provohet, sipas përcaktimit të bërë nga neni 13 i KPC-së... Në këto rrethana gjykata, vlerëson se pala e paditur mund të ketë qenë e justifikuar në marrjen e këtij vendimi, por gjatë hetimit gjyqësor të çështjes nuk u provuan shkaqet e pretenduara prej saj...*” (faqe 6 e vendimit). Në të njëjtën linjë arsyetimi është edhe vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë (faqe 3 e vendimit).

17. Ndërsa Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë është shprehur se: “*Së fundi, Kolegji Administrativ nuk e gjen të mbështetur në ligj qëndrimin e dy gjykatave më të ulëta kur arsyetojnë se në gjykim pala e paditur nuk paraqiti prova për të vërtetuar motivet e zgjidhjes së kontratës së punës me paditësin Nezir Bata, përkatësisht lidhur me provën filmike të transmetuar në mediat elektronike. Kolegji Administrativ në këtë aspekt vëren se vetë paditësi në padinë e ngritur para gjykatës pranon se ka pasur një regjistrim audio-video, se ky filmim është transmetuar në programin “Fiks fare” [...] dhe se [...] gjatë gjyqimit do të japë të dhëna dhe do të sqarojë pozicionin e tij. Nga gjykimi nuk rezulton që paditësi të ketë dhënë shpjegime që qartësojnë pozicionin e tij lidhur me filmin e transmetuar në media. Ai nuk e ka mohuar ekzistencën e filmimit, madje në mbrojtje të pozitës së tij shprehet se edhe vetë pala e paditur, me një shkresë të mëvonshme, shprehet se nuk janë të sigurt nëse vajza e shfaqur në filmimin që ngarkon paditësin është apo jo studente e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja. Po kështu, përveçse nuk do të kishte asnjë peshë përcaktuese fakti nëse vajza ishte apo jo studente e këtij Fakulteti në raport me sjelljen e paligjshme që i atribuohet nga pala e paditur punëdhënëse paditësit punëmarrës, nga gjykimi nuk rezulton që të ketë pasur ndonjë investim, kryesisht apo me interesimin e vetë paditësit, të organeve kompetente, përfshirë ato të ndjekjes penale dhe gjykatave, lidhur me pavërtetësinë e rrethanave që përmbaheshin në filmim, mbi bazën e të cilit, pala e paditur, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, motivoi vendimin e saj për zgjidhjen e kontratës së punës me paditësin për shkelje flagrante të disiplinës në punë, thyerje të figurës morale të pedagogut dhe abuzim me detyrën.*”

18. Nisur nga sa më sipër, Gjykata çmon se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në rastin konkret është bazuar në vendim në një provë (filmimi audio-video), e cila nuk është administruar dhe nuk është debatuar nga gjykatat e faktit. Këtë filmim gjykatat e faktit nuk e kanë konsideruar si provë dhe nuk e kanë administruar si të tillë. Gjykata konstaton se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka arritur në konkluzion të ndryshëm nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Apelit Tiranë për sa i përket vlerësimit të këtij filmimi. Sipas jurisprudencës kushtetuese, Gjykata e Lartë jo vetëm nuk ka kompetencën të administrojë prova të reja, por, gjithashtu, nuk mund të vlerësojë ndryshe provat e vlerësuara nga gjykatat e faktit, si dhe nuk mund të anashkalojë ekzistencën e fakteve dhe të rrethanave që janë vërtetuar në gjykimin e faktit apo t'i ndryshojë ato (*shih vendimet nr. 53, datë 20.7.2015; nr. 40, datë 25.6.2015; nr. 27, datë 24.6.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Për rrjedhojë, bazuar në standardet e mësipërme dhe rrethanat e çështjes konkrete, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin nga Gjykata e Lartë të parimit të gjykatës së caktuar me ligj, në kuptim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, është i bazuar.

*C. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit në Gjykatën e Lartë*

20. Kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës së aksesit, pasi duke rrëzuar padinë Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk i ka shqyrtuar në mënyrë substanciale pretendimet e tij për rikthim në punë. Sipas kërkuesit një gjë e tillë ka cenuar në thelb jo vetëm të drejtën e aksesit, por edhe të drejtën e rehabilitimit e të zhdëmtimit të personit për shkak të veprimeve dhe akteve të

paligjshme të administratës publike (neni 44 i Kushtetutës).

21. Në nenin 42/2 të Kushtetutës parashikohet se kushdo për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetuese dhe ligjore ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Kjo dispozitë sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, që është e drejta për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Në rast se mohohet kjo e drejtë procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesit në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës (*shih vendimet nr. 8, datë 26.2.2015; nr. 52, datë 14.11.2014; nr. 6, datë 26.2.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Në rastin konkret, Gjykata, duke pasur parasysh rrethanat faktike të çështjes, çmon se në kuptimin kushtetues kërkuesi ka pasur akses të plotë në gjykatë, në të gjitha shkallët e gjykimit. Ai jo vetëm ka realizuar të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës, për t'u dëgjuar prej saj, por edhe të drejtën për të pasur një zgjidhje përfundimtare për çështjen. Edhe pse rekursi në Gjykatën e Lartë është paraqitur nga pala e paditur në procesin gjyqësor, kërkuesi është vënë në dijeni për rekursin dhe procesin në atë gjykatë dhe ka pasur mundësinë të paraqesë kundërshtitë e tij për argumentet e palës tjetër.

23. Për pasojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë është i pabazuar.

*Ç. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm*

24. Kërkuesi ka pretenduar se gjykimi i çështjes së tij në të tria shkallët e gjykimit ka zgjatur për rreth 7 vjet, edhe pse çështja nuk paraqet kompleksitet dhe as sjellja e kërkuesit nuk ka qenë e tillë që të zvarrisë gjykimin. Sipas tij edhe pse në shkallë të parë dhe në Apel çështja është gjykuar shpejt, në Gjykatën e Lartë shqyrtimi i rekursit është bërë pas rreth 5 vjetësh, kurse vendimi është zbardhur pas rreth 4 muajsh nga dhënia e vendimit.

25. Gjykata e ka përfshirë në juridiksionin e saj edhe kontrollin e arsyeshmërisë së kohëzgjatjes së shqyrtimit gjyqësor, si element i së drejtës për në proces të rregullt ligjor, i garantuar nga neni 42 i Kushtetutës. Gjykata ka vlerësuar se kohëzgjatja e procedurave normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procedurës gjyqësore, deri në momentin kur jepet vendimi dhe ekzekutohet ai. Për vlerësimin e pretendimit për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm Gjykata merr në shqyrtim disa kriteret që janë rrethanat e veçanta të çështjes, duke pasur parasysh kompleksitetin e saj, sjelljen e kërkuesit, sjelljen e autoriteteve, si dhe rrezikun që sjell për kërkuesin kjo tejzgjatje e afateve të gjykimit (*shih vendimet nr. 35, datë 17.7.2013; nr. 12, datë 5.3.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Në rastin konkret rezulton se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është i datës 9.6.2008 dhe vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë është i datës 25.11.2009. Në Gjykatën e Lartë kjo çështje është regjistruar në datën 31.3.2010 (sipas të dhënave që ndodhen në faqen zyrtare elektronike të Gjykatës së Lartë). Pasi ka kaluar fazën e seleksionimit për këtë çështje është vendosur kalimi për shqyrtim në seancë plenare, e cila është zhvilluar në datën 4.11.2014, seancë në të cilën është dhënë edhe vendimi nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë. Bazuar në këto rrethana faktike, Gjykata konstaton se që nga viti 2009, në të cilin është dhënë vendimi i Gjykatës së Apelit, deri në vitin 2014, kur është dhënë vendimi i Gjykatës së Lartë, kanë kaluar 5 vjet.

27. Gjykata çmon se çështja konkrete nuk paraqet kompleksitet nga pikëpamja faktike ose ligjore. Kërkesa në themel ka për objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis kërkuarit dhe subjektit të interesuar për sa u përket marrëdhënieve të punës ndërmjet tyre. Rekursi i paraqitur nga subjekti i interesuar nuk përmban pretendime të një natyre të tillë, të cilat do të kërkonin një kohë të gjatë për t'u shqyrtuar.

28. As sjellja e kërkuarit gjatë gjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë, në vlerësimin e Gjykatës, nuk është bërë pengesë për realizimin e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm. Përkundrazi, ai ka shfaqur interes të vazhdueshëm për ecurinë e procesit gjyqësor. Kështu me anë të shkresës së datës 14.6.2013, kërkuari i është drejtuar Gjykatës së Lartë duke vënë në dukje vonesën e gjykimit dhe duke kërkuar përshpejtimin e tij. Gjithashtu, me shkresat nr. n-103 prot., datë 17.12.2014, n-105 prot., datë 23.12.2014, n-14 prot., datë 17.2.2015 dhe n-24 prot., datë 20.3.2015 kërkuari i ka kërkuar Gjykatës së Lartë vënien në dispozicion të vendimit të arsyetuar, pasi kishin kaluar më shumë se katër muaj nga dhënia e vendimit.

29. Duke pasur parasysh këto rrethana faktike, mungesën e kompleksitetit të çështjes dhe sjelljen e kërkuarit, Gjykata vlerëson se kohëzgjatja e gjykimit në Gjykatën e Lartë në rastin konkret nuk mund të konsiderohet e arsyeshme. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuarit në drejtim të cenimit të së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm është i bazuar.

30. Si konkluzion, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuarit për cenimin nga Gjykata e Lartë të parimit të gjykatës së caktuar me ligj dhe të së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, janë të bazuara dhe duhen pranuar.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1, shkronja "g", të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

#### VENDOSI:

- Pranimin e pjesshëm të kërkesës.
- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 00-2014-4337 (578), datë 4.11.2014 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Vladimir Kristo, Besnik Imeraj, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Sokol Berberi, Fatos Lulo

#### MENDIM PARALEL

1. Gjykata ka vendosur shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 00-2014-4337 (578), datë 4.11.2014 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë. Edhe pse në qëndrimin përfundimtar pajtohem me vendimin e shumicës, cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj e shoh edhe nën një këndvështrim tjetër.

2. Parimi i gjykatës së caktuar me ligj është trajtuar gjerësisht në jurisprudencën e Gjykatës. Lidhur me vlerësimin e provave nga Gjykata e Lartë, sikurse thekson edhe shumica në vendimin e saj (*shih paragrafin nr. 19 të vendimit*), kjo e fundit jo vetëm nuk ka kompetencën të administrojë prova të reja, por, gjithashtu, nuk mund të vlerësojë ndryshe provat e vlerësuara nga gjykatat e faktit, si dhe nuk mund të anashkalojë ekzistencën e fakteve dhe të rrethanave që janë vërtetuar në gjykimin e faktit apo t'i ndryshojë ato (*shih vendimet nr. 53, datë 20.7.2015; nr. 40, datë 25.6.2015; nr. 27, datë*

24.6.2013 të Gjykatës Kushtetuese).

3. Konkretisht, sipas jurisprudencës kushtetuese, parimi i gjykatës së caktuar me ligj konsiderohet i cenuar, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, kur Kolegji i Gjykatës së Lartë, mbi të njëjtat prova e fakte të vlerësuara në gjykimet e mëparshme, vendos të prishë vendimet dhe ta zgjidhë vetë çështjen, për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit (*shih vendimet nr. 27, datë 24.6.2013 dhe nr. 7, datë 9.3.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata është shprehur se në ushtrimin e funksionit të saj si gjykatë e ligjit, Gjykata e Lartë mund të vendosë për themelin e çështjes vetëm nëse mosmarrëveshja mund të zgjidhet në bazë të të njëjtave fakte e prova të vlerësuara nga gjyqtari i faktit dhe që përbëjnë bazën e vendimit në të cilin është bërë një interpretim i gabuar i ligjit. Kontrolli i saj duhet të fokusohet vetëm në drejtim të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankimuara, pra mbi mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Gjykata e Lartë nuk mund të anashkalojë apo të lërë pa vlerë prova që janë shqyrtuar dhe vlerësuar nga gjykatat e faktit, si dhe nuk mund të pranojë prova të cilat nuk janë administruar në gjykimin në fakt (*shih vendimin nr. 32, datë 25.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

3. Gjithashtu, Gjykata ka vlerësuar se Gjykata e Lartë nuk mund të konkludojë *a priori* nëse është vërtetuar apo jo një fakt i caktuar. Në rast se Gjykata e Lartë vlerëson se provat e administruara nuk janë të mjaftueshme për arritjen e një konkluzioni apo se nevojitet kryerja e vlerësimeve të mëtejshme të tyre, ajo nuk mund të marrë kompetencat e gjykatës të faktit, pasi një veprim i tillë bie ndesh me parimin e gjykatës së caktuar me ligj, por duhet ta kthejë çështjen për rishqyrtim, me qëllim plotësimin e këtyre të metave të vendimit. Nëse Kolegji Administrativ ka arritur në një përfundim të ndryshëm nga gjykatat e faktit, atëherë ai duhet t'i prishë të dyja vendimet gjyqësore dhe ta kthejë çështjen për rigjykim (*shih vendimin nr. 32, datë 25.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

4. Në rastin në shqyrtim jam dakord me përfundimin e shumicës se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë është bazuar në vendim në një provë (filmimi audio-video), e cila nuk është administruar dhe nuk është debatuar nga gjykatat e faktit dhe se ka arritur në konkluzion të ndryshëm nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Apelit Tiranë për sa i përket vlerësimit të këtij filmimi. Prandaj pajtohem me vendimin e shumicës se për këtë arsye është cenuar parimi i gjykatës së caktuar me ligj në procesin e zhvilluar në Gjykatë të Lartë.

5. Gjithsesi, në ndryshim nga shumica, mendoj se ky parim duhej trajtuar edhe më gjerë. Në rastin në fjalë, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, ka vendosur “*Ndryshimin e vendimit nr. 5326, datë 9.6.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të vendimit nr. 1612, datë 25.11.2009 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe rrëzimin e padisë*.”

6. Kompetencat e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë janë të parashikuara në nenin 63 të ligjit nr. 49, datë 3.5.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”. Sipas përcaktimeve të këtij neni, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk mund të prishë vendimet e gjykatave të faktit dhe të shprehet mbi themelin e çështjes. Edhe pse Gjykata e Lartë mund të ndryshojë vendimet e gjykatave më të ulëta, jam i mendimit se prishja e vendimit nuk është e njëjta gjë me ndryshimin e tij. Në të gjitha rastet e parashikuara nga neni 63 i ligjit të lartpërmendur, prishja e vendimit të gjykatave të faktit lidhet me rikthimin e çështjes për rishqyrtim në atë gjykatë (shih nenin 63, shkronjat “b”, “c” dhe “d”). Ndërsa ndryshimi i vendimit mendoj se nuk ka të bëjë me themelin e tij, por me lënien në fuqi të vendimit me ndonjë ndryshim që Gjykata e Lartë e quan të nevojshëm. Ky qëndrim i ligjvënësit mendoj se është në të njëjtën linjë edhe me rolin e Gjykatës së Lartë si gjykatë ligji. Në të kundërt, nëse Gjykata e Lartë do të prishte vendimin dhe do të shqyrtonte themelin e çështjes, ajo nuk do të mund t'i shmangej vlerësimit të provave, gjë që do ta kthente atë në gjykatë fakti të shkallës së tretë, duke kompromentuar, në këtë mënyrë, rolin dhe misionin e saj.

7. Në rastin konkret, Gjykata e Lartë edhe pse në dispozitiv ka përdorur fjalën “ndryshim vendimi” *de facto* ajo i ka prishur vendimet e gjykatave të faktit dhe ka rrëzuar kërkesëpadinë e

kërkuesit, duke shqyrtuar në këtë mënyrë themelin e çështjes, në tejkalim të kompetencave të sanksionuara në nenin 141 të Kushtetutës, në kuptim të funksionit rishikues të Gjykatës së Lartë.

8. Si përfundim, mendoj se vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë i ka cenuar kërkuesit të drejtën për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosrespektimit të parimit të gjykatës së caktuar me ligj si në aspektin e vlerësimit të provave, ashtu edhe në prishjen e vendimit dhe shqyrtimin e themelit të çështjes.

Anëtar: Vladimir Kristo